

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "RUBIX ENERGY" Sh.p.k

Ne Tirane, sot me date 13.03.2022(dymije e njezet e dy), nenshkruhet ky Akt Themelimi i Shoqerise " **RUBIX ENERGY**" Shpk nga: "**Rubix Holding Group**" sh.p.k. shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar e regjistruar si person juridik prane qendres kombetare te regjistrimit Tirane me **NUIS M21508003D** me adrese. **Torre Drin Rruget, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane**. E cila, me zotesi te plote juridike per te vepruar, nenshkruan kete Akt Themelimi te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " **RUBIX ENERGY**" Shpk.

Neni 1

Forma e shoqerise

Ortaket themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ne kuptimin qe pergjegjesia e secilit prej ortakeve eshte e kufizuar deri ne shumen e kapitalit te Shoqerise, pa iu njohur asnje pergjegjesi tjeter.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emertimi i shoqerise eshte "" **RUBIX ENERGY** " Sh.p.k.

Neni 3

Baza juridike

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat e Statutit dhe Aktit te Themelimit.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Veprimtaria e Shoqerise " **RUBIX ENERGY**" Shpk do te ketë për objekt:

Tregtimi energjise - Import dhe eksport, tregti me pakice dhe shumice, sherbime, instalime, projektim dhe mirembajtje te sistemeve elektrike ne tension te ulet dhe te mesem, UPS e inverter, gjeneratore, stabilizator, ndertim linjash elektrike mbitokesore, ajrore, kabllore e nentokesore per energjine elektrike, linja fuqie dhe telekomunikacioni, nenstacione elektrike, punime elektrike civile dhe ne industri, sherbime dhe punime ne te gjitha fushat qe lidhen me prodhimin, transmetimin dhe shperndarjen e energjise duke perfshire sistemet e matjes inteligjente dhe rrjetat inteligjente te energjise, zgjidhje hardware dhe software ne sektorin e energjise e te ngjashme. Import dhe eksport, tregti me pakice dhe shumice, sherbime, instalime, projektim, krijim, integrim dhe mirembajtje te sistemeve telekomunikacion, rrjete kompjuterike dhe telefonie si dhe te lidhura me internetin, pajisje dhe aparatura elektronike ne te gjitha fushat, pajisje per zyra dhe kancelarike, informatike, sisteme wireless, pajisje kompjuterike hardware e software, faqe interneti e sherbime te tjera online e te ngjashme. Shitje, sherbime dhe instalime ne fushen e hidraulikes, mekanikes, ajrit te kondicionuar, ashensoreve, portave automatike e te ngjashme. Tregti, instalim, sherbime dhe mirembajtje te sistemeve te sigurise (sistemeve te survejimit dhe vzhgimit CCTV, akses kontroll, kunder vjedhjes, dedektimit te zjarrit, fonise, radio nderlidhjes etj.) e te ngjashme. Çdo aktivitet tjeter tregtar qe lidhet ne menyre te drejteperdrejte ose tertnorazi me objektet e mesiperme te veprimtarise dhe qe eshte ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Menaxhim projektesh, nenkontraktim sherbimesh ne te gjitha fushat e siperpermendura me lart.



Neni 5**Selia**

Selia e Shoqerise " **RUBIX ENERGY**" Shpk eshte ne adresen: **Torre Drin Rrugen, "Abdi toptani", Njesia Bashkiake Nr: 2 office 46/1 Kati 2 Tirane. Shqiperi.**

Neni 6**Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

Neni 7**Kapitali i shoqerise**

Kapitali themeltar i shoqerise " **RUBIX ENERGY**" Shpk eshte 10 000 (dhjetemije) Leke, dhe eshte depozituar ne nje llogari bankare te vecante sipas percaktimeve ligjore. Kapitali do te ndahet ne 1 (nje) kuot. Ky kapital eshte formuar nga themeluesja e shoqerise si me poshte: "**Rubix Holding Group**" sh.p.k. me 10 000 (dhjetemije) leke duke zoteruar 100 % te kuotave 1 (nje kuot).

Neni 8**Administrimi**

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem me nje mandat 5(pese) vjecar.

Administratori i pare i shoqerise eshte Z. **Edmond Petraj**

Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.

Neni 9**Te ardhurat**

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve themelues te shoqerise ne raport me kuotat e tyre ne kapitalin fillestar. Te ardhurat qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se vitit ushtrimor, ne perputhje me parashikimet e statutit dhe pas pagimit te tatimeve, dhe rezerves se domosdoshme, te konkretizuara ne bilance, mund te ndahen ndermjet ortakeve ne raport me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin e shoqerise.

Neni 10

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundertet, kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky Akt themelimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, eshte hartuar ne 4 kopje ne gjuhen Shqipe dhe nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKET THEMELUES: "Rubix Holding Group"

Administratori Edmond Petraj

